

## **Shtyhet thirrja për bursa në kuadër të programit Erasmus + në Universitetin e Studimeve të Mesinës, në Itali, për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.**

Universiteti i Tiranës shtyn thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin e Studimeve të Mesinës, në Itali në kuadër të programit Erasmus +, për studentët, për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

### **Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Master;

- PhD;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

-Master (6muaj);

-PhD (6 muaj);

### **Fushat e studimit:**

-Biologji;

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti i Studimeve të Mesinës klikoni në linkun:

<https://international.unime.it/>

### **Bursat përfshijnë:**

-Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Master**:

- CV (në gjuhën angleze/italiane);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit të nivelit Master (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/italiane);
- Listë notash e nivelit Bachelor (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane);
- Listë notash e nivelit Master (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze/italiane);
- Formulari i Aplikimit, sipas formatit:

<https://www.unime.it/sites/default/files/Application%20form%20KA107%20UNIMEa.doc>

- Certifikatë e gjuhës së huaj B2(Anglisht/Italisht në varësi të programit të studimit);

-\*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas*

nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: [http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning\\_Agreement.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf)

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **PhD**,

- CV (në gjuhën angleze/ italiane);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti të nivelit PhD (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/ italiane);
- Listë notash e nivelit Master (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/ italiane);
- Listë notash e nivelit PhD (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/ italiane);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze/ italiane);
- Formulari i Aplikimit, sipas formatit:

<https://www.unime.it/sites/default/files/Application%20form%20KA107%20UNIMEa.doc>

- Plani i kërkimit, sipas formatit:

[https://www.unime.it/sites/default/files/RESEARCH%20PROPOSAL\\_0.doc](https://www.unime.it/sites/default/files/RESEARCH%20PROPOSAL_0.doc)

- Certifikatë e gjuhës së huaj B2 (Anglisht/Italisht në varësi të programit të studimit) ;

- \*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning\\_Agreement.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf)

**Afati për aplikim:** 06 Maj 2019

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!